



ГРАД СКОПЈЕ - QYTETI I SHKUPIT

Бр. Nr. 08-4429

07-04-2026 20

СКОПЈЕ - SHKUP

QYTETI I SHKUPIT
SEKTORI PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL
SHKUP

**SHTOJCA E APLIKIMIT
PËR NDARJEN E MJETEVE PËR FINANCIMIN E MANIFESTIMIT:**

"FESTIVALI I VERËS – VINOSKOP"

**PËRMBAJTJET DHE KRITERET QË DUHET TË PËRMBUSHEN NGA REALIZUESI I
MANIFESTIMIT: "FESTIVALI I VERËS – VINOSKOP"**

1. PËRMBAJTJA E MANIFESTIMIT:

Manifestimi të jetë destinacion për prezantim dhe degustim të verërave të ndryshme të siguruara nga bodrumet më të mëdha vendase të verës dhe nga shtetet e huaja, argëtim i vazhdueshëm me muzikë dhe performanca argëtuese si nga vendi, ashtu edhe nga shtetet e huaja.

- Të ofrojë listë bashkëpunimi me ekspozuesit e verës dhe të dërgojë ftesa për pjesëmarrje në bodrumet e verës ;
- Ftesë për pjesëmarrje për prezantuesit e kulinarisë (restorante, pica, taverna, kafene dhe të ngjashme) dhe bodrume të verës sipas zgjedhjes së organizatorit të Projektit;
- Ftesë për shoqatat kulturore - artistike për pjesëmarrje në manifestim nga vendi dhe nga jashtë;
- Ftesë për pjesëmarrje nga grupe të njohura vendase dhe të huaja muzikore;
- Ofertë për një projekt të shkurtër për organizimin e vlerësimit profesional të verës;
- Ceremonia e hapjes së manifestimit nga Kryetari i Qytetit të Shkupit;
- Sigurimi i verërave cilësore dhe shitja e tyre.
- Pastrimi i lokacionit dhe rikthimi në gjendjen si para përdorimit.

2. KUSHTET PËR REALIZIMIN E MANIFESTIMIT

- Përvojë në organizimin dhe koordinimin e ngjarjeve dhe festivaleve me natyrë të lidhur me verën, të paktën pesë vjet;
- Koha e mbajtjes - në konsultim me Qytetin e Shkupit;
- Vendndodhja: Vendndodhje tërheqëse në konsultim me Qytetin e Shkupit;

- Infrastruktura: në marrëveshje me Qytetin e Shkupit; - rrethimi i pjesës ku do të zhvillohet evenimenti,
 - instalimi elektrik,
 - zëri dhe ndriçimi i përshtatshëm sipas vendndodhjes dhe ambienteve,
 - instalimi hidraulik,
 - organizatori i evenimentit, në bashkëpunim me Sektorin e ZHEL dhe Sektorin për punë komunale të Qytetit të Shkupit, të sigurojë pastrimin e vendit ku do të mbahet evenimenti para dhe pas evenimentit (në bashkëpunim me NP "Higjiena komunale" e Qytetit të Shkupit),
 - sigurimi i pajisjeve sanitare mobile për të ruajtur higjienën e evenimentit (kontratë me një kompani përkatëse),
 - një numër i përshtatshëm tualetesh mobile (toi-fore) sipas numrit të mysafirëve të pritur,
 - tenda përfaqësuese për shitje, stenda, banakë, tavolina dhe stola për vizitorët,
 - sigurimi i animacionit aktiv të përshtatshëm të evenimentit sipas programit të evenimentit (skicë e shkurtër e një projekti me ide),
 - posedimi i pajisjeve të përshtatshme për logjistikën e evenimentit,
 - sigurimi i pajisjeve të përshtatshme muzikore për të përmbushur programin muzikor të evenimentit (kontratë ose para kontratë me një kompani për pajisjet e përshtatshme),
 - një skenë e madhe ku do të prezantohen grupe muzikore vendase dhe të huaja.
 - Logoja e Qytetit të Shkupit do të vendoset në një vend të dukshëm në skenë, si dhe në hyrje të lokacionit,
 - elementë të tjerë të infrastrukturës që do të propozohen nga zbatuesi dhe ekspozuesit;
- Siguria (në marrëveshje me Qytetin e Shkupit dhe Ministrinë e Brendshme);
 - Punësimi i një agjencie për të ruajtur rendin publik në lokacion;
 - Prodhimi i materialit përfaqësues dhe promovues;
 - Mbulimi mediatik i ngjarjes, si nga media elektronike ashtu edhe nga ajo e shkruar (një javë para ngjarjes, reklamat dhe spotet të transmetohen nga të paktën 3 stacione televizive dhe 3 radio stacione, si dhe informacioni në gazetatat ditore);
 - Sigurimi i një drafti - propozimi grafik të përshtatshëm për materialin promovues të ngjarjes (poster, fletushkë, broshurë, pllakë, shënim falënderimi);
 - Mbajtja e një regjistri të veçantë të dokumenteve mbi të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me organizimin e ngjarjes, i cili do t'i dorëzohet qytetit pas përfundimit të ngjarjes.

3. KRITERET PËR LIDHJEN E KONTRATËS PAS THIRRJES PUBLIKE

Për bartësin e Kontratës në lidhje me Thirrjen publike do të zgjidhet ai aplikim që do të vlerësohet si më e favorshme nga totali i pikëve për secilin element në veçanti.

Kritere	Maksimum pikët
1. Struktura organizative dhe resurset	30
1.1 Aplikanti ka strukturën e nevojshme organizative dhe burimet njerëzore për realizimin e manifestimit (punonjës, vullnetarë aktivë, individë të angazhuar me kontratë, etj).	10
1.2 Aplikanti disponon me logjistikë (hapësirë zyre dhe	10

pajisje teknike për realizimin e manifestimit).	
1.3 Dukshmëria e aplikantit në internet	10
2. Financimi i propozim projektit për realizimin e manifestimit	30
2.1 Plani financiar i detajuar për mjetet e nevojshme për realizimin e manifestimit.	10
2.2 Aplikanti siguron një përqindje të pjesëmarrjes së tij në realizimin e projektit.	10
2.3 Plan financiar real (përshkrimi i shpenzimeve sipas pozicioneve të kategorive përkon me çmimet e tregut).	10
3. Kualiteti i propozim projektit për realizimin e manifestimit	40
3.1 Qëllimi i përgjithshëm i qartë dhe i përcaktuar i propozim projektit, i cili do të sjellë realizimin e prioriteteve të dhëna. Nga Programi për aktivitete nga fusha e zhvillimit ekonomik lokal të Qytetit të Shkupit	10
3.2 Zgjidhje cilësore dhe inovative të ofruara në projektin e propozuar.	10
3.3 Sigurimi i përfshirjes së institucioneve dhe organizatave të tjera.	10
4 Projekti i propozuar për realizimin e manifestimit është i qartë dhe i realizueshëm.	10

*Çdo fushë e kriterëve të veçanta do të vlerësohet me 1 pikë, 5 pikë ose 10 pikë, me kuptimin e mëposhtëm: 1 - jo, 5 - pjesërisht, dhe 10 - po.

*Shënim:

- Në projektin e propozuar duhet të dorëzohet listë e bodrumeve të verës që do të marrin pjesë në manifestim;
- Duhet të dorëzohet pëlqim i nënshkruar për regjistrimin e interesit për pjesëmarrje në manifestim, për secilin bodrum të verës dhe objekt gastronomik veç e veç;
- Duhet të përmendet eksperiencia e aplikantit në organizimin e manifestimeve (kur vlerësohet, do të merret parasysh organizimi i manifestimeve të ngjashme në lidhje me numrin e pjesëmarrësve, kohëzgjatjen, etj.);
- Në projektin e dorëzuar të paraqitet program argëtimi (emra muzikorë, etj.);
- Të dorëzohen biografi të organizatorëve të manifestimit.

KRYETARI I QYTETIT TË SHKUPIT
Orce Gjorgjievski